

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

- Gjatësia e druve të jetë sipas standartit shtetëror 95 cm deri 105 cm
- Shënimi i druve që do të priten, prerja, transporti, pastrimi dhe dorëzimi do të bëhen në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr 2 datë 03.03.2017 “ Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”.
- Gjatë ndërhyrjes në ngastra të caktuara për vjeljen e materialit drusor nuk do të pritet apo dëmtohet asnjë nga llojet e listës së kuqe të përcaktuara në VKM-në nt. 804 datë 4.12.2003 “ Për miratimin e listës së specieve të florës shiqiptare që vihen në mbrojtje”.
- Lartësia e druve të stivosura të jetë sipas Udhëzimit nr 2 datë 03.03.2017 “ Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grup ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”, kreu 8 Depozitimi dhe stivimi i materialit drusor, **pika 2, gërma d.**
- Të mos ketë dru të kalbura gjatë dorezimit .
- Transporti i largët i tyre nga venddepozitimi i caktuar i parcelave deri në vendin e caktuar të Bashkisë Përmet, duke bërë te mundur matjen e volumit të mallit.
- Shërbimi do të bëhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor për kohën dhe sasinë , brenda kohës së përfundimit të kontratës.

## SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

NR	EMËRTIMI	Ekonomia Pyjore	Njësia	Sasia
1	Prerje e materialit drusor lis në këmbë (të paprerë) dhe transporti i largët i tyre nga venddepozitimi i caktuar i parcelave deri në vendin e caktuar të Bashkisë, Qyteti Përmet	Parcelat nr. 115, 116/a, të ekonomisë pyjore Nemërçkë.	m/sterë	1813
	<b>TOTALI</b>		<b>m/sterë</b>	<b>1813</b>

Afatet e ekzekutimit:

Bazuar në VKM nr.438 datë 08.06.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”, kreu III pika 5, periudha e prerjes së materialit drusor lis në këmbë (të paprerë) do jetë nga **data 1 tetor 2020** dhe përfundon në **31 mars të vitit 2021** ,

si dhe Udhëzimit nr 2 datë 03.03.2017 “ Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje, **kreu IV Prerja dhe assortimi, pika 1.**

**Ndërsa ,**

Transporti i largët i tyre nga venddepozitimi i caktuar i parcelave deri në vendin e caktuar të Bashkisë, Qyteti Përmet do jetë data **31 Dhjetor 2021.**

**Komisionit të Përgatitjes së specifikimeve teknike dhe termave të referencave .**

- |    |         |
|----|---------|
| 1. | Kryetar |
| 2. | Anëtar  |
| 3. | Anëtar  |